



Instituti Shkollor Përmbledhës Sigillo

Shkolla e Fëmijërisë, Shkolla Elementare e Shkolla e Mesme e Shkollës së Parë

(Kopshti i Fëmijëve, Cikli i Ulët e Cikli i Lartë i Shkollës 8-Vjeçare)

në vendet

Fossato di Vico, Sigillo, Costacciaro e Scheggia-Pascelupo



INFORMACIONE TË DOBISHME DHE RREGULLORJA

Viti shkollor 2011/12

Tel. 075.9178760 Zyrat Administrative

Fax 075 9178771

075.9178764 Presidenza

pgic82200q@istruzione.it

www.iscsigillo.it

Vendi	Shkolla e Fëmijërisë (3 – 6 vjeç) (Kopshti i fëmijëve)	Shkolla Elementare (6 – 11 vjeç) (Cikli i ulët)	Shkolla e Mesme e Shkollës se Pare (11– 14 vjeç) Cikli i lartë i shkollës 8-vjeçare
Fossato di Vico	Via della Stazione Tel. 075 9190174 da lun. a vener. 8,30 – 16,30	Via F. Venturi Tel. 075 9190169 da lun. a sabato 8,00 – 13,00	Via F. Venturi Tel. 075 9149478 da lun. a sabato 8,25 – 13,25 lun. e giov. 14,25-16,25 13,25–14,25 mensa
Sigillo	Purello Tel. 075 9190209 da lun. a vener. 8,30 – 16,30 8,30 – 13,00	Via Umbria,5 Tel. 075 9178763 da lun. a sabato 8,10 – 13,10	Via Umbria,5 Tel. 075 9178770 da lun. a sabato 8,05 – 13,05 Lun. e giov. 14,05-16,05 13,05-14,05 mensa
Costacciaro	Villa Col de'Canali Tel. 075 91704 55 da lun. a vener 8,30 – 16,30	P.zza Garibaldi Tel. 075 9170764 da lun. a sabato 8,00 – 13,00	P.zza Garibaldi Tel. 075 917 0764 da lun. a sabato 8,00 – 13,00 lun. e giov. 14,00 -16,00 13,00–14,00 mensa
Scheggia	<i>////</i>	Via delle Scuole Tel. 075 9259247 da lun. a sabato 8,15 – 13,15	Via Delle Scuole Tel. 075 9259247 da lun. a sabato 8,15 – 13,15 lun. e giov. 14,15-16,15 13,15–14,15 mensa

Transporti

Shërbimi i transportit me autobuzin e shkollës varet nga orari i shkollës. Ky shërbim, me pagesë, kryhet sipas kërkesës drejtuar Komunes në të cilën ndodhet shkolla.

Shërbimi i mencës

Shërbimi i mencës funksionon çdo ditë në kopshtin e fëmijëve. Në Shkollën dytësore të shkollës I° (ciklin e lartë të shkollës 8-vjeçare) shërbimi i mencës funksionon vetëm në ditët kur ka shkollë edhe mbasdite.

Është e mundur të ndryshohet menu-ja javore për nevoja personale(për shembull: alergji,dieta, besimi fetar) vetëm duke bërë kërkesën në fillim të vitit shkollor dhe/ose duke paraqitur çertifikatën në zyrat e Komunes në të cilën ndodhet Shkolla.

Zyrat e Sekretarisë: via Umbria, 5 – Sigillo (PG)

Tel. 075 9178760 fax- 075 91778771

Çdo ditë, nga ora 10.00 në orën 12.30

Zyra është në dispozicion për lëshimin e dokumentave të mëposhtme:

- Praktika të regjistrimit
- Çertifikata të regjistrimit
- Atestime
- Nulla osta në rast transferimi
- Praktika sigurative

Drejtori i Shkollës: Dott. ssa Maria Marinangeli

Tel. 075 9178764

Zyra e Drejtorisë pret publikun çdo ditë
parapëlqehet të merret më parë takim.

SHKOLLA,ME QËLLIM QË TË RREGULLOJË E TË SISTEMOJË DITËN SHKOLLORE T NXËNËSVË TË INSTITUTIT NË TË GJITHA MOMENTET E SAJ, KOMUNIKON DISPOZITAT E MËPOSHTME :

1. Nxënësit janë të detyruar të kenë në drejtim të të gjithë Personelit, të shokëve dhe ambientit një sjellje të respektueshme, konform me bashkëjetesën civile.Do të ndëshkohen me ashpërsi të gjitha episodet e violencës fizike e verbale që do të verifikohen midis nxënësve dhe në drejtim të kujtdo.Të gjithë duhet të kenë mundësinë të frekuentojnë shkollën me qetësi, pa vuajtur prepotencën e të tjerëve.
2. Nxënësit janë të detyruar të frekuentojnë rregullisht shkollën.
3. Nxënësit janë të detyruar të respektojnë orarin e hyrjes në shkollë, por mund të hyjnë në shkollë edhe 15 minuta përpara fillimit të leksioneve.Nxënësit me vonesë përse i përket orarit të leksionit (mësimi),lejohe të hyjnë në klasë me vendim të Mësuesit në shërbim, që shënon situatën në regjistrin e klasës. Është detyrë e grupit të profesorëve të thërrasë Prindërit në rast se verifikohen vonesa sistematike.
4. Në fund të leksioneve(mësimi) nxënësit duhet të dalin nga dera e shkollës me rregull, të shoqëruar nga Mësuesit, klasë për klasë. Në rast vonese të një Prindi , nxënësi do të lihet nën kujdesin e Bashkpuntores shkollore (pastrueses). Mbikqyrja e nxënësve zgjat maksimumi 10minuta.Me tejkalimin e kësaj kohe personeli i ngarkuar informon, sipas normave në fuqi, Policine Urbane ose Karabinieret
5. Nxënësit mund të largohen nga shkolla përpara se të mbarojë mësimi vetëm për motive të justifikuara e të jashtëzakonshme dhe vetëm se tërhiqen drejtpërdrejt nga njeri prej Prindërve ose nga një familjar i njohur të cilit i është lëshuar delegimi nga familja, duke marrë më parë autorizimin e Profesorit të klasës.

6. Për mungesa me shkak sëmundjeje, kur mungesat zgjasin mbi 5 ditë, është e nevojshme certifikata e mjekut ose autoçertifikata e prindit në modularin përkatës. Për mungesa jo për shkak sëmundjeje e që zgjasin mbi 5 ditë, është e nevojshme që prindi të njoftojë në mënyrë paraprake, e sidoqoftë, jo më vonë se dita e parë e mungesës.
7. Në Shkollën e mesme të shkallës së parë, (ciklin e lartë të shkollës 8-vjeçare) mungesat duhet të jenë justifikuar, vetëm në librezën përkatëse, në ditën e parë të rikthimit të nxënësit në shkollë. Në rast mungese të justifikimit, menjëherë nga dita e dytë, lajmërohet familja me telefon nga ana e personelit të Sekretarisë ose nga Profesori i orës së parë. Mbas ditës së tretë të mungesës së justifikimit nxënësi duhet të jetë i shoqëruar në shkollë nga njeri prej prindërve.
8. Nxënësit, që për arsye shëndeti nuk mund të ndjekin leksionet (orët) e Edukimit Fizik, duhet të paraqesin kërkesën e përjashtimit Drejtorit të Shkollës, të firmosur nga Prindi dhe certifikatën e duhur mjeksore bashkangjitur me kërkesën.
9. Për nxënësit që gjatë daljeve për qëllime mësimore, visitave të udhëhequra ose udhëtimeve instruktive do të shfaqin sjellje të rënda, që vënë në rrezik sigurinë e vet dhe atë të të tjerëve, dotë merren masa të menjëhershme.
10. Nxënësit janë të detyruar të sjellin në shkollë vetëm çka duhet për detyrat dhe leksionet (orët e mësimi) si edhe zamrën për pushimin e gjatë. Nuk është e këshillueshme të sillen në shkollë shuma lekësh ose objekte me vlerë. Shkolla, në çdo rast, nuk përgjigjet për vjedhje të mundshme.
11. Është i ndaluar përdorimi i çelularit (ose i dispozitivave elektronike të përdorimit personal) gjatë gjithë orarit shkollor.
12. Nxënësit duhet të perpiqen për kryerjen e plotë të detyrave të shtëpisë.

13. Të gjithë nxënësit janë të detyruar të përdorin një veshje dinjitoze e të përshtatshme për ambientin shkollor.
Nxënësit që frekuentojnë Shkollën fillore duhet të veshin përparsen ngjyrë blu, për Kopshtin e fëmijëve me katronë blu e rozë.

Prindërit janë të detyruar të :

- bëjnë që fëmijët e tyre të respektojnë këtë rregullore;
- controllojnë, lexojnë e firmosin në kohën e duhur komunikacionet e dërguara nga Drejtori, nga Mësuesit, si edhe çdo shënim tjetër në ditarin personal të nxënësit;
- marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e parashikuara me prezencën konkrete dhe bashkëpunim në klasa nëpërmjet iniciativave të mëposhtme:
 - *Asamble të shkollës*
 - *Asamble të klasës*
 - *Takime periodike për vlerësimin*
 - *Aktivizim i Prindërve në inicitativa e manifestime*
 - *Aktivizim në projektet e shkollës*
 - *Kurse të informimit/formimit me tematike edukative*
- tërheqin, në momentin e regjistrimit Rregulloren komplete, të gjithë modularet e nevojshëm dhe të firmosin Paktin edukativ të bashkëpërgjegjësisë midis Shkollës, familjes, nxënësit;
- flasin me Profesorët gjatë orarit shkollor. Janë parashikuar takime të posaçme në një kalendar vjetor ose edhe në takime në marrëveshje me palët e interesuara.
- Prindërit mund të mblidhen në Asamble e të përdorin lokalet e shkollës duke lajmëruar të paktën 5 dite përpara,

vetëm mbasi të kenë marrë përpara autorizimin e Drejtorit të shkollës, sipas kërkesës së motivuar, me pikët e qarta të rendit të ditës dhe me përgjegjësinë, formalizuar në deklaratë, të ruajtjes së mobiljeve, të strukturës, të higjenës e të pastërtisë së lokalit.

- Prindërit janë të detyruar të tërheqin skedën e vlerësimeve simestrale të fëmijëve të tyre dhe t'a dorzojnë brenda tre ditëve , detyrimisht të firmosur. Prindërit mungues në ditën e caktuar do t'a tërheqin në Sekretarinë e shkollës.
- Në rast greve, Prindërit duhet të shoqërojnë personalisht në shkollë nxënësit ose të delegojnë një person për ta të besuar dhe të sigurohen që Mësuesit e klasës të jenë prezent. Në rast mungese të Mësuesve përgjegjësia bie mbi Prindërit.

SANKSIONE DISIPLINARE

Në rast se nuk respektohet rregullorja e brendshme e ISC do të aplikohen sanksione disiplinare në proporcion me thyerjen:

- ⇒ thirrje verbale nga ana e mësuesit;
- ⇒ komunikim familjes;
- ⇒ shënim në rregjistrin e klasës dhe komunikim familjes;
- ⇒ për dëmtimin e strukturës e /ose të materialeve didaktike familja është e detyruar të blejë materialin ekuivalent e/ose gjobë;
- ⇒ përjashtim nga mësimi (shkolla), që do të vlerësohet sipas rastit, për një/tre/pesë ose më shumë ditë.

PRITJA DHE INTEGRIMI I NXËNËSVE TË HUAJ

Kopshtet e fëmijëve, shkollat elementare e të mesme të shkallës së parë mirëpresin nxënësit e huaj duke garantuar mundësi të përshtatshme formimi e duke konsideruar një situatë të tillë ,edhe pse komplekse, një burim edukimi për nxënës e mësues.

Prezenca e nxënësve të huaj është një rast ballafaqimi, njohjeje, edukimi e respekti për kultura e besime të ndryshme.

Në periudhën e parë të shkollës ata ndiqen duke i kushtuar kujdes fazës së pritjes dhe më pas atyre u dedikohen orët e bashkëpranisë me të tjerët;ata ndiqen, kur është e nevojshme, me aktivitete rriaftësimi.

Integrimi i tyre në klasa varion shumë.

Një Comision i posaçëm sinjalizon modalitetet dhe përkatësinë.

Entet(Komunet,Drejtoria Shkollore e Rrethit, Prefektura dhe Rrethi) përpiqen të pajisin shkollat me burime financiare e profesionale mbi bazën e Projekteve të detajuara të prezentuara nga shkolla.